L I G J
Nr.9545, datë 29.5.2006

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8981, DATË 12.12.2002 "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Pas nenit 1/2 shtohet neni 1/3 me këtë përmbajtje:

"Neni 1/3

Reduktohen në 0 për qind tarifat doganore për:

a) artikujt e nomenklaturës me kode doganore 27 10 11 41 deri në 27 10 11 59 dhe 27 10 19 31 deri në 27 10 19 69, sipas aneksit 1/1 që i bashkëlidhet këtij ligji;

b) artikujt e importit të vendeve, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë, me kodet doganore të përcaktuara në shkronjën "a", sipas aneksit 1/1 që i bashkëlidhet këtij ligji.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4936, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKS 1/1

NDRYSHIMET E TARIFËS DOGANORE

Kodi	**Përshkrimi**	**Është**	**Bëhet**
	Të tjera me përmbajtje plumbi deri në 0,013 gr/litër		
27 10 11 41	Me një numër oktanesh më pak se 95	10%	0%
27 10 11 45	Me një numër oktanesh prej 95 apo më shumë, por më pak se 98	10%	0%
27 10 11 49	Me një numër oktanesh prej 98 apo më shumë	10%	0%
	Mbi 0,013 g për litër		
27 10 11 51	Me një numër oktanesh prej më pak se 98	10%	0%
27 10 11 59	Me një numër oktanesh prej 98 apo më shumë	10%	0%
	Gazoili		
27 10 19 31	Për të përshkruar një proces specifik	2%	0%
27 10 19 35	Për të përshkruar transformimin kimik nëpërmjet një procesi ndryshe nga ato të	2%	0%

	specifikuara në nënkreun 27 10 19 31		
27 10 19 41	Me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 0,05% ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 45	Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 0,05% ndaj peshës, por jo më tepër se 0,2% ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 49	Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 0,2% ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 51	Për të përshkruar një proces specifik	2%	0%
27 10 19 55	Për të përshkruar transformimin kimik nëpërmjet një procesi ndryshe nga ato të specifikuara në nënkreun 27 10 19 51	2%	0%
27 10 19 61	Me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 63	Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 1% ndaj peshës, por jo më tepër se 2 % ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 65	Me një përmbajtje sulfuri me tepër se 2% ndaj peshës, por jo më tepër se 2,8% ndaj peshës	10%	0%
27 10 19 69	Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 2,8% ndaj peshës	10%	0%